



Pranuar / Dorezuar Prilijeno / Predato Received / Delivery	19.11.2021	viti god year	
Organ / Njësia Organ / Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKOMSHOR	5549/2021		1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.843/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Arben Mehmeti-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.843/2021 të datës 01.10.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë rruga "Adem Jashari", në Komunën e Dragashit, kundër Vendimit KA.nr.43/2021 të datës 01.09.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 19.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.843/2021 e datës 01.10.2021 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi KA.nr.43/2021 i datës 01.09.2021 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi - Ndhmës Administrator pranë Gjykatës Themelore në Prizren-dega në Dragash, me datë 01.09.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 4859/2021 të regjistruar me numër A.nr.843/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit KA.nr.43/2021 të datës 01.09.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë të Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Këshilli, me datë 21.10.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kryesuesi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për shërbimin Civil të Kosovës, më datë 15.11.2021 ka nxjerr Vendim VK.nr.50/2021 me të cilin ka bërë vazhdimin e afatit për vendosjen e ankesës së ankuesit për 10 ditë pune, sipas kërkesës se kryetarit të Kolegjit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 4859/2021 të regjistruar me numër A.nr.843/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin KA.nr.43/2021 e datës 01.09.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Aktgjykimin C.nr.2025/2021 të Gjykatës Themelore në Prizren; Zarin e datës 29.09.2021; Përgjigjen në ankesë e datës 26.10.2021; Vendimin DS-33/2021 të datës 19.01.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të SKGJK-së; Ankesën e datës 28.07.2021 të ankuesit për Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimin DS-309/2021 të datës 14.06.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të SKGJK-së; Kërkesën e datës 01.06.2021 të ankuesit; Listën e Pagave e datës 31.03.2021; Fletëdërgesë e datës 03.09.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është e pabazuar, ***sepse:***

Përmes Vendimit me numër reference DS:33/2021 të 18.01.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të SKGJK-së, ankuesit i ka përfunduar marrëdhënia e punës me datë 06.02.2021 për shkak të arritjes së moshës së pensionimit. Të njëjtit me këtë vendim i është njohur e drejta e një page të njëhershme në vlerën e pagës së fundit, dhe kompensimi i një pagese në vlerë prej 50 euro për muajin janar dhe shkurt 2021, sipas Vendimit të Qeverisë Nr.18/60 të datës 07.08.2018. Kolegji bazuar në shkresat e lëndës, gjegjësisht listat e pagave të muajit mars 2021 ka konstatuar se ankuesit i janë realizuar të drejtat e njohura mbi kompensimin e një page të njëhershme dhe shtesave sipas vendimit për përfundimin e marrëdhënies së punës, dhe atë shumën prej 726.66 euro.

Ankuesi më datë 01.06.2021 ka parashtruar kërkesë të Drejtori i Administratës së Përgjithshme dhe Personelit në SKGJK, për kompensimin e dy pagave të plotë mujore në vlerën e pagës së fundit dhe tri pagave jubilarë sipas Kontratës së Përgjithshme Kolektive të Kosovës. Drejtori i Përgjithshëm i SKGJK-së me datë 10.06.2021 ka nxjerr Vendimin me numër reference DS-309/2021 përmes të cilit ka refuzuar kërkesën e ankuesit, me arsyetimin se të njëjtit i janë njohur të drejtat sipas dispozitave ligjore në fuqi, përkatësisht nenit 22 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe nenit 19 paragrafi 2 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensimet Tjera të Nëpunësve Civilë.

Ankuesi kundër Vendimit DS-309/2021 të datës 10.06.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të SKGJK-së, me datë 28.07.2021 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të SKGJK-së. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me datë 01.09.2021 ka nxjerr Vendim KA.nr.43/2021 me të cilin ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankuesit.

Ankuesi kundër Vendimit KA.nr.43/2021 të datës 01.09.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të SKGJK-së, me datë 29.09.2021 përmes postës ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të Shkeljes thelbësore të dispozitave të LPA-së; Vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike; dhe Zbatimit të gabuar të drejtës materiale, dhe rrjedhimisht i njëjti pretendon në njohjen e drejtës për kompensimin e dy pagave përcjellëse me rastin e pensionimit dhe tri pagave jubilarë sipas Kontratës së Përgjithshme Kolektive në Kosovë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore ka analizuar Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive të Kosovës të publikuar në Gazetën Zyrtare Nr.38/2014 me datë 18.06.2014, mbi bazën e të cilës janë ngritur pretendimet ankimore, dhe rrjedhimisht ka konstatuar se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës ka hyrë në fuqi me datë 01.01.2015 dhe e njëjta sipas nenit 90 paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, ka qenë e zbatueshme në periudhë jo me shumë se tri (3) vjet, respektivisht deri me datë 31.12.2017. Kolegji po ashtu ka konstatuar se Oda Ekonomike e Kosovës si Partner i barabartë në Këshillin Ekonomiko Social, dhe njëherit nënshkruese e MPKK-së, me datë 15.09.2017 është tërhequr nga zbatimi i MPKK-së, dhe rrjedhimisht ka pamundësuar zbatimin e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, pas datës 31.12.2017. Andaj, duke marr parasysh se ankuesit sipas fuqisë ligjore i ka përfunduar marrëdhënia e punës me datë 06.02.2021, pretendimet ankimore të ankuesit mbi këtë bazë ligjore janë të pa bazuara.

Andaj, pas konstatimit se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës nuk ka qenë në fuqi në kohën e përfundimit të marrëdhënies së punës së ankuesit, Kolegji konstaton se kompensimi i pagave përcjellës dhe pagave jubilarë me rastin e pensionimit të ankuesit bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe dispozitat e Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë, kështu që Drejtori i Përgjithshëm i SKGJK-së me rastin e nxjerrjes së Vendimit DS-33/2021 të datës 19.01.2021 dhe Vendimit DS-309/2021 të datës 14.06.2021, me të cilin ankuesit i është njohur e drejta e kompensimit të një page përcjellëse me rastin e pensionimit, respektivisht i është refuzuar kërkesa për kompensimin edhe të dy pagave përcjellëse dhe tri pagave jubilarë, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë, andaj pretendimet ankimore të ankuesit në këtë kuptim janë të pabazuara.

Kolegji po ashtu vlerëson se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave pranë SKGJK-së me rastin e nxjerrjes së Vendimit KA.nr.43/2021 të datës 01.09.2021 ka vërtetuar drejte gjendjen faktike dhe ka zbatuar drejtë ligjin material, duke vepruar kështu në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë, si dhe dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nënenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 si dhe nënenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.843/2021

Avdyll BEKTESHI

Procesmbajtës



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në SKGJK; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

